

largohej me fëmijët. Trupat e Habibit dhe Hysenit kanë mbetur në vendin e vrasjes deri në datën 28.09.1998, kur ato i zbuloi Imer Deliu. Hyseni ishte i shtrirë për toke, ndërsa mbi të ishte i shtrirë Habibi me fytyrën të kthyer nga toka. Në shpinë i kishte të gdhendur me thikë kryqin dhe katër shkronja "S" në alfabetin serb ("C"). Imeri i ka varrosur viktimat më 30.09.1998, në njëjtin vend ku më parë ishin varrosur viktimat të tjera nga familja Deliu. Për fatin e Antigones dhe Mihanes nuk dihet asgjë deri më 5.10.1998, kur fshatarët i zbuluan trupat e tyre të masakruar në një bunker të braktisur të forcave serbe pranë rrugës që çon në Likoc/Likovac. Edhe këto dy vajza u varrosën në fushën në pronë të Imer Deliu, sikurse edhe anëtarët të tjerë të vrarë të familjes Deliu. Pas përfundimit të luftës, në datën 26.09.1999, mbetjet mortore të Antigones, Mihanes, Habibit dhe Hysenit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Obri të Epërme/Gornje Obrinje.

Burimet: deklarata F.D, FDH-8888; deklarata F.D, FDH-16500; deklarata Z.D, FDH-8884; deklarata I.D, FDH-8883; deklarata I.D, FDH-16499; deklarata M.D, FDH-8891; deklarata I.D, FDH-33503; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9 tetor-dhjetor 1998,117, FDH-23857; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284; deklarata Z.D, FDH-8884.

Xhevdet (Isa) Demiçi

(10.01.1957, shqiptar nga Obria e Epërme/ Gornje Obrinje, komuna e Gillogocit/Glogovac, bujk)

Xhevdeti që nga fëmijëria vuante nga epilepsia dhe tërë jetën e përcillte shëndeti i dobët. Jetonte në *Mëhallën Demiçi* me vëllain Izetin, familjen e tij dhe motrat Shkurten dhe Selvijen. Në të njëjtin oborr jetonte edhe miku i tij Ismeti me familje. Kur forcat serbe, më **26.09.1998**, e morën **Obrinë e Epërme/Gornje Obrinje**, vëllezërit e Xhevdetit me familjet e veta e braktisën fshatin, ndërkaq Xhevdeti ka mbetur në shtëpi. Familjarët u kthyen në fshat më 29.09.1998, por Xhevdeti nuk ishte në shtëpi. Vëllezërit e tij mësuuan nga komshiu Musli Demaku se Xhevdetin e kishin vrarë dhe se kufoma e tij gjendet

në oborrin e të fqinjët Rrustem Demiçi. Po atë ditë, Xhevdetin e varrosën në varrezat lokale. Në shatorin e vitit 1999, patologët nga Portugalia i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Xhevdetit për të kryer ekzaminime. Tri ditë më vonë, familjarët sërish i kanë varrosur ato në të njëjtin vend.

Burimet: deklarata I.D, FDH-16501; deklarata I.D, FDH-33504; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, FDH-23857; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284.

Fitim (Din) Jakupi

(13.10.1978, shqiptar nga Cerroviku/Cerovik, komuna e Klinës/Klina, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Fitimi u bë pjesëtar i UÇK-së në fund të vitit 1997. Kohën më të madhe e kalonte në pozicionet e UÇK-së përreth fshatit të tij. Ka rënë në betejë me forcat serbe, e cila u zhvillua në qendër të fshatit **Vuçak/Vuçak** më **26.09.1998**. Po atë ditë, banorët e fshatit e kanë varrosur atë në varrezat lokale. Në përvjetorin e vrasjes së Fitimit, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e tij mortore në Cerrovikë/Cerovik. U varros në fushën që është në pronësi familjare, afro 50 metra larg shtëpisë.

Burimet: deklarata S.J, FDH-19325; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 105, FDH-23857; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Bilall (Brahim) Demaku

(1930, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Gillogocit/Glogovac, bujk, i martuar)

Bilalli e kishte shtëpinë në *Mëhallën Demaku* [Obri e Epërme/Gornje Obrinje]. Në datën **27.09.1998**, familja e tij, së bashku me fqinjët e tyre, e ka braktisur mëhallën dhe u strehua në pyllin e afërt. Bilalli ka mbetur vetëm në shtëpi. Të nesërmen, kur forcat serbe u tërhoqën, familjarët e kanë zbuluar trupin e tij brenda në shtëpi [**Obri e Epërme/Gornje Obrinje**]. Në gjoks i kishte plagët e shumta nga plumbat. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Bilallin në varrezat lokale.

Burimet: deklarata H.D, FDH-16525; deklarata I.D, FDH-33503; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9,